

Prishtinë: 03 May 2007
Kodi i ZRrE-së: D_45_2007

Duke marrë parasysh:

1. Nenin 15 dhe 34 a) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe
2. Nenin 4 dhe 6 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në seancën e mbajtur më May 03, 2007 ka nxjerrë këtë:

VENDIM

REFUZOHET aplikacioni i SAS GROUP AG, ENERGY ENTERPRISE, për Licencë për Furnizim/Tregti me Energji Elektrike.

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) me datë 17.11.2006 ka pranuar aplikacionin për licencë Furnizim/Tregti me Energji Elektrike të dërguar nga kompania **SAS Group AG, Energy Enterprise, Zvicër.**
2. Gjatë vlerësimit të parë të aplikacionit dhe dëshmime të dërguara janë vërtetuar shumë mangësi në dëshmitë e dërguara si dhe mospërputhje të termave dhe emrave të kompanive.
3. Nga përfaqësuesit e Kompanisë janë kërkuar sqarime lidhur me mangësitë në fjalë dhe janë kërkuar:
 - I. Dëshmitë e përvojës së aplikuesit në lëmin e energjisë (CV-në) – pika 8 nga aplikacioni duke përfshirë:
 - a) dëshmitë materiale (dokumente me shkrim) për çdo transaksion të energjisë elektrike që është kryer paraprakisht;
 - b) informata për palëve kontraktuese; dhe
 - c) informata për sasinë e energjisë elektrike e kontraktuar;
 - II. Faturën e taksave relevante të aplikueshme – pika 11 e aplikacionit për licencë
4. Në kontaktet e drejtpërdrejta me përfaqësuesit e Kompanisë në fjalë si dhe me e-mailat më datën 01.12.2006, me 04.12.2006 dhe me 05.12.2006 janë kërkuar të dërgohen dëshmitë e përmendura në pikën 3.
5. Me datë 27.03.2007 edhe njëherë kemi kërkuar që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh të dërgohen dëshmitë e kërkuara.

6. Pasi palës është lejuar afati i duhur ligjor dhe deri më sot nuk janë dërguar asnjëra nga dëshmitë e kërkuara, ZRrE ka vendosur që aplikacioni i **SAS GROUP AG, ENERGY ENTERPRISE** për Licencë Furnizim/Tregti të Energjisë Elektrike të refuzohet.
7. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të sundojë versioni në gjuhën shqipe.
8. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në Gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRrE-së.
9. Ky Vendim hyn në fuqi datën e lëshimit ose datën e publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRrE-së

Bordi i ZRrE-së:

Ali Hamiti
Kryesues

Merita Kostari
Anëtare

Theranda Beqiri
Anëtare

Naim Bejtullahu
Anëtar

Nysret Avdiu
Anëtar